REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 308, Datë 26.10.2026

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "MBI NDRYSHIMIN E FURNIZUESIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të neneve 16, 19, 20 dhe 111, pika 4, të ligjit nr. 59/2026 *"Për sektorin e energjisë elektrike"*, si dhe neneve15 dhe 26 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 3151 prot., datë 22.10.2026, të Grupit të Punës, të ngritur me Urdhrin e Kryetarit të ERE-s nr. 138, datë 18.08.2026, *"Mbi fillimin e procedurës administrative për miratimin e Rregullores 'Mbi ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike'"*,

Konstatoi se:

- Neni 111 i ligjit nr. 59/2026 *"Për sektorin e energjisë elektrike"*, përcakton të drejtën e klientëve fundorë për të ndryshuar furnizuesin e energjisë elektrike, kushtet dhe afatet e realizimit të kësaj procedure, si dhe rregullat lidhur me kostot përkatëse. Në veçanti, pika 4 e këtij neni ngarkon ERE-n me miratimin e rregullave për ndryshimin e furnizuesit, duke përfshirë kushtet e ndryshimit, detyrimet e furnizuesit të ri lidhur me balancimin, shkëmbimin e informacionit ndërmjet palëve dhe trajtimin e detyrimeve financiare të klientit ndaj furnizuesit të mëparshëm.
- Aktualisht, ndryshimi i furnizuesit të energjisë elektrike rregullohet nga Rregullorja *"Mbi ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike"*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 113, datë 08.07.2016, e ndryshuar me vendimin nr. 10, datë 24.01.2019. Kjo rregullore është hartuar në zbatim të ligjit nr. 43/2015 *"Për sektorin e energjisë elektrike"*, dhe përcakton procedura që mbështeten kryesisht në paraqitjen e kërkesave dhe dokumentacionit në formë shkresore, si dhe në shkëmbimin e informacionit ndërmjet furnizuesve dhe operatorëve të sistemit.
- Neni 136, pika 2, i ligjit nr. 59/2026 parashikon se aktet nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit nr. 43/2015 vazhdojnë të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me ligjin e ri. Në këtë kuadër, vlerësohet e nevojshme hartimi i një rregulloreje të re, me qëllim harmonizimin e procedurave ekzistuese për ndryshimin e furnizuesit me kërkesat e kuadrit të ri ligjor.
- Në zbatim të ligjit nr. 59/2026 dhe Urdhrit të Kryetarit të ERE-s nr. 138, datë 18.08.2026, *"Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e akteve për furnizimin dhe mbrojtjen e klientëve"*, Grupi i Punës ka hartuar projekt-rregulloren *"Mbi ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike"*, me qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave për realizimin e ndryshimit të furnizuesit, garantimin e së drejtës së klientit fundor për zgjedhjen e lirë të furnizuesit dhe sigurimin e një procesi transparent, jodiskriminues dhe pa pengesa të pajustifikuara.
- Në raport me rregulloren ekzistuese, projekt-rregullorja parashikon ndryshime në mënyrën e administrimit të procedurës, duke synuar lehtësimin e procesit për klientët fundorë, reduktimin e barrës administrative dhe rritjen e transparencës dhe gjurmueshmërisë së

veprimeve. Në këtë kuadër, parashikohet zhvillimi i procedurës nëpërmjet platformave elektronike të administruara nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), për klientët e lidhur në sistemin e shpërndarjes, dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST), për klientët e lidhur në sistemin e transmetimit, si dhe paraqitja e kërkesës nga klienti ose furnizuesi i ri, mbi bazën e autorizimit të klientit.

- Projekt-rregullorja synon gjithashtu thjeshtimin e kërkesave për dokumentacion, nëpërmjet përdorimit të informacionit të disponueshëm në platformat elektronike dhe kufizimit të kërkesave për dokumente të përsëritura. Ky parashikim synon reduktimin e barrës administrative dhe të kostove që lidhen me përgatitjen dhe paraqitjen e dokumentacionit nga klientët fundorë.
- Në lidhje me detyrimet financiare, projekt-rregullorja pasqyron kushtet e përcaktuara në nenin 111, pika 4, shkronja "ç", të ligjit nr. 59/2026, duke parashikuar mundësinë e ndryshimit të furnizuesit kur klienti ka shlyer detyrimet ndaj furnizuesit aktual, ka lidhur marrëveshje për shlyerjen e tyre me këste ose kur furnizuesi i ri merr përsipër detyrimet e mëparshme, sipas marrëveshjes ndërmjet palëve. Ndryshe nga rregullorja ekzistuese, projekt-rregullorja nuk përfshin mekanizmin e parashikuar në nenin 5, pikat 1.3 dhe 1.4, të saj, lidhur me kërkimin e ndërprerjes së furnizimit nga furnizuesi i mëparshëm pas ndryshimit të furnizuesit**.** Gjithashtu, parashikohet që refuzimi i kërkesës të jetë i arsyetuar, duke përcaktuar shkaqet faktike dhe ligjore dhe duke siguruar dokumentimin e tij në platformën elektronike, pa cenuar detyrimin e klientit për shlyerjen e detyrimeve financiare.
- Sa u përket afateve, projekt-rregullorja pasqyron përcaktimet e nenit 111, pika 7, të ligjit nr. 59/2026, sipas të cilave procedura e ndryshimit të furnizuesit duhet të përfundojë brenda një afati maksimal prej tri javësh, ndërsa procesi teknik i ndryshimit nuk duhet të zgjasë më shumë se 24 orë, pas plotësimit të kushteve përkatëse. Në krahasim me afatin maksimal prej 15 ditësh të parashikuar në rregulloren ekzistuese, afati prej tri javësh përbën kufirin maksimal të përcaktuar nga ligji nr. 59/2026 për përfundimin e procedurës, ndërsa afati i prej 24 orësh për realizimin e procesit teknik synon të garantojë kryerjen e ndryshimit pa vonesa të pajustifikuara, pas plotësimit të kushteve përkatëse.
- Projekt-rregullorja përfshin parashikime për mbrojtjen e klientëve nga kostot që mund të pengojnë ndryshimin e furnizuesit, duke përcaktuar mbrojtje të posaçme për klientët familjarë dhe ndërmarrjet mikro e të vogla nga tarifat e lidhura me ndryshimin, si dhe kushtet dhe kufizimet për zbatimin e tarifave të përfundimit të parakohshëm të kontratave me çmim fiks dhe afat të caktuar për kategoritë e tjera të klientëve, në përputhje me nenin 111, pika 3, të ligjit nr. 59/2026.
- Projekt-rregullorja parashikon regjistrimin elektronik të kërkesave, komunikimeve, afateve dhe historikut të veprimeve, si dhe aksesin e autorizuar të ERE-s në informacionin përkatës, me qëllim monitorimin e respektimit të procedurës dhe shqyrtimin e ankesave. Gjithashtu, parashikohen rregulla për mbrojtjen e të dhënave personale, kufizimin e aksesit dhe gjurmueshmërinë e veprimeve të kryera në platformë.
- Projekt-rregullorja parashikon gjithashtu mundësinë e furnizimit të klientëve nga më shumë se një furnizues, sipas kushteve të përcaktuara në ligj, si dhe pjesëmarrjen e klientëve familjarë dhe ndërmarrjeve mikro e të vogla në skemat kolektive të ndryshimit të furnizuesit, duke ruajtur të drejtën e tyre për zgjedhjen e lirë të furnizuesit. Gjithashtu, përcaktohet detyrimi për vënien në dispozicion të klientit të informacionit përfundimtar mbi konsumin dhe gjendjen financiare të mbylljes së llogarisë brenda 20 ditëve nga ndryshimi i furnizuesit, në përputhje me nenin 117, pika 2, shkronja "gj", të ligjit nr. 59/2026.
- Në lidhje me furnizuesin e mundësisë së fundit, projekt-rregullorja i referohet neneve 109 dhe 110 të ligjit nr. 59/2026 dhe akteve të posaçme të ERE-s, duke shmangur përsëritjen e procedurave të detajuara të parashikuara në rregulloren ekzistuese dhe duke synuar harmonizimin e trajtimit të këtyre rasteve me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.
- Projekt-rregullorja përmban 21 nene, të cilat përcaktojnë qëllimin, objektin, përkufizimet, kushtet dhe procedurën e ndryshimit të furnizuesit, të drejtat dhe detyrimet e klientëve,

furnizuesve dhe operatorëve të sistemit, afatet, trajtimin e detyrimeve financiare, administrimin elektronik të procedurës, mbrojtjen e të dhënave personale, monitorimin, ankimin dhe dispozitat përfundimtare.

- Gjatë procesit të konsultimit publik do të kërkohen dhe shqyrtohen komentet e furnizuesve të energjisë elektrike, OST-së, OSSH-së, organizatave të konsumatorëve dhe palëve të tjera të interesuara, duke i kushtuar vëmendje të veçantë afateve procedurale, mënyrës së njoftimit dhe trajtimit të refuzimeve, funksionimit të platformave elektronike, mundësisë së përdorimit të kanaleve alternative për klientët, si dhe zbatimit të procedurës gjatë periudhës kalimtare ose në rastet e mosfunksionimit të platformave.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën administrative për miratimin e Rregullores *"Mbi ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike"*, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Projekt-rregullorja *"Mbi ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike"* t'i nënshtrohet procedurës së konsultimit dhe shqyrtimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe procedurat e përcaktuara nga ERE për miratimin e akteve rregullatore.

3. Ngarkohet Grupi i Punës për ndjekjen e procedurës, kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale lidhur me publikimin dhe konsultimin e projektaktit, administrimin dhe shqyrtimin e komenteve, vërejtjeve dhe propozimeve të paraqitura, si dhe organizimin e seancave dëgjimore, sipas nevojës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

Miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 308, Datë 26.10.2026

PROJEKT-RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN E FURNIZUESIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore përcakton kushtet, rregullat dhe procedurat për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike nga klienti fundor, si dhe të drejtat dhe detyrimet e klientit fundor, të furnizuesit aktual, të furnizuesit të ri dhe të operatorit të sistemit me të cilin është i lidhur klienti fundor. Procedura zhvillohet në mënyrë të digjitalizuar, nëpërmjet platformës elektronike të ndryshimit të furnizuesit, të administruar nga operatori përkatës i sistemit, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.

Neni 2
Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është garantimi i së drejtës së klientit fundor për të zgjedhur dhe për të ndryshuar furnizuesin, përcaktimi i hapave të procedurës, i afateve dhe i përgjegjësive të palëve, si dhe sigurimi i trajtimit jodiskriminues të klientëve për sa u përket kostos, përpjekjes dhe kohës.

2. Kjo rregullore zbatohet për klientët fundorë të lidhur në sistemin e transmetimit ose në sistemin e shpërndarjes, përfshirë rastet kur klienti jofamiljar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, furnizohet nga më shumë se një furnizues.

Neni 3
Baza ligjore

Kjo rregullore mbështetet në:

a) ligjin nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”, veçanërisht në nenet 19, 100, 101, 109, 111, 112 dhe 117 të tij;

b) ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

c) ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar;

ç) ligjin nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;

d) Kodin e Transmetimit;

dh) Kodin e Shpërndarjes;

e) Kodin e Matjes;

ë) aktet e tjera nënligjore dhe rregullatore të miratuara në zbatim të ligjit nr. 59/2026.

Neni 4
Përkufizime

1. Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Ditë" është ditë kalendarike, përveç rasteve kur kjo rregullore përcakton shprehimisht ditë pune.

b) "ERE" është Enti Rregullator i Energjisë, autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

c) "Furnizues" është shoqëria e licencuar për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit me energji elektrike.

ç) "Furnizues aktual" është furnizuesi që furnizon klientin fundor deri në datën e përfundimit të procedurës së ndryshimit të furnizuesit.

d) "Furnizues i mundësisë së fundit" është furnizuesi i caktuar në përputhje me nenet 109 dhe 110 të ligjit nr. 59/2026.

dh) "Furnizues i ri" është furnizuesi i zgjedhur nga klienti fundor, me të cilin klienti synon të lidhë kontratë të re furnizimi.

e) "Klient familjar" është klienti që blen energji elektrike vetëm për konsumin e tij familjar, pa përfshirë konsumin për veprimtari tregtare ose profesionale.

ë) "Klient fundor" është klienti që blen energji elektrike vetëm për përdorim vetjak.

f) "Kodi i klientit për ndryshimin e furnizuesit" është kodi ose identifikuesi unik që përdoret për identifikimin e klientit dhe/ose të pikës së furnizimit në procedurën e ndryshimit të furnizuesit.

g) "Ndërmarrje mikro dhe e vogël" është ndërmarrja e klasifikuar si e tillë sipas legjislacionit në fuqi.

gj) "Operator i sistemit" është OST-ja ose OSSH-ja, sipas sistemit me të cilin është i lidhur klienti fundor.

h) "OSSH" është operatori i sistemit të shpërndarjes.

i) "OST" është operatori i sistemit të transmetimit.

j) "Pikë furnizimi" është pika e lidhjes së klientit fundor me sistemin e transmetimit ose të shpërndarjes, sipas rastit.

k) "Platformë elektronike" është sistemi elektronik, i administruar nga OST-ja ose OSSH-ja, sipas sistemit me të cilin është i lidhur klienti, nëpërmjet të cilit regjistrohet, administrohet, komunikohet dhe gjurmohet procedura e ndryshimit të furnizuesit.

l) “Proces teknik i ndryshimit” është procesi që kryhet nga operatori i sistemit për realizimin teknik të ndryshimit të furnizuesit në regjistrat dhe në sistemet përkatëse, pas plotësimit të kushteve të nevojshme.

2. Termat e tjerë të përdorur në këtë rregullore kanë kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 59/2026 dhe në aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

Neni 5
E drejta për të ndryshuar furnizuesin dhe kushtet financiare

1. Çdo klient fundor ka të drejtë të zgjedhë dhe të ndryshojë furnizuesin, sipas kushteve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe në kontratën e furnizimit.

2. Ndryshimi i furnizuesit kryhet pa kosto shtesë për klientin, me përjashtim të tarifës së përfundimit të parakohshëm të kontratës, e cila mund të zbatohet vetëm në kushtet e nenit 111, pika 3, të ligjit nr. 59/2026.

3. Klientët familjarë dhe ndërmarrjet mikro dhe të vogla nuk ngarkohen me tarifa të lidhura me ndryshimin e furnizuesit.

4. Për klientët e tjerë, tarifa e përfundimit të parakohshëm mund të zbatohet vetëm kur kontrata me çmim fiks dhe me afat të caktuar e parashikon shprehimisht, tarifa është komunikuar qartë para lidhjes së kontratës, është proporcionale dhe nuk e tejkalon humbjen e drejtpërdrejtë ekonomike të furnizuesit. Zbatimi i saj u nënshtrohet rregullave dhe metodologjisë së miratuar paraprakisht nga ERE-ja.

5. Furnizuesi aktual vazhdon furnizimin e klientit deri në përfundimin e procedurës së ndryshimit të furnizuesit.

PJESA II
PROCEDURA E NDRYSHIMIT TË FURNIZUESIT

Neni 6
Fillimi i procedurës dhe paraqitja e kërkesës

1. Procedura e ndryshimit të furnizuesit administrohet nëpërmjet platformës elektronike të operatorit përkatës të sistemit, përkatësisht platformës së administruar nga OSSH-ja për klientët e lidhur në sistemin e shpërndarjes dhe platformës së administruar nga OST-ja për klientët e lidhur në sistemin e transmetimit. Kjo dispozitë nuk cenon të drejtën e klientit fundor për ta paraqitur kërkesën në formë shkresore pranë operatorit përkatës të sistemit, i cili e regjistron atë në platformë.

2. Kërkesa mund të paraqitet nga klienti ose, mbi bazën e autorizimit të tij, nëpërmjet furnizuesit të ri. Autorizimi i klientit dokumentohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Platforma mundëson identifikimin e klientit, të pikës së furnizimit dhe të furnizuesit aktual, si dhe regjistrimin e furnizuesit të ri, të datës së kërkesës, të statusit të procedurës, të komunikimeve dhe të vendimeve të marra gjatë procedurës.

4. Kërkesa përmban të paktën: kodin unik të identifikimit të pikës së furnizimit ose kodin e klientit për ndryshimin e furnizuesit, të dhënat e identifikimit të klientit, furnizuesin e zgjedhur, deklaratën ose autorizimin e klientit, si dhe të dhënat e nevojshme për përpunimin e kërkesës.

5. Operatorët e sistemit publikojnë në platformën përkatëse formularin elektronik dhe fushat e detyrueshme të aplikimit. Nuk kërkohet paraqitja e të njëjtit informacion në formë shkresore, kur ky informacion është regjistruar dhe verifikuar në platformë.

Neni 7
Verifikimi i detyrimeve ndaj furnizuesit aktual

1. Pas regjistrimit të kërkesës, furnizuesi aktual verifikon në platformë gjendjen e detyrimeve të klientit dhe statusin e kontratës.

2. Ekzistenca e detyrimeve ndaj furnizuesit aktual nuk përbën, në vetvete, pengesë për ndryshimin e furnizuesit, kur plotësohet njëri nga kushtet e mëposhtme:

a) klienti ka shlyer detyrimet ndaj furnizuesit aktual;

b) klienti ka lidhur me furnizuesin aktual marrëveshje për shlyerjen me këste të detyrimeve të papaguara;

c) ekziston një marrëveshje ndërmjet furnizuesit aktual dhe furnizuesit të ri, sipas së cilës furnizuesi i ri merr përsipër detyrimet e papaguara të klientit.

3. Furnizuesi aktual nuk mund ta refuzojë ndryshimin e furnizuesit për arsye të ndryshme nga ato që lejohen nga ligji nr. 59/2026 dhe nga kjo rregullore.

4. Çdo refuzim regjistrohet në platformë dhe është i arsyetuar, me përcaktimin e bazës ligjore dhe faktike. Platforma ua vë këtë informacion në dispozicion klientit dhe furnizuesit të ri.

Neni 8
Roli dhe detyrimet e furnizuesit të ri

1. Furnizuesi i ri duhet të jetë i licencuar dhe të përmbushë kushtet e pjesëmarrjes në treg dhe të përgjegjësisë për balancimin, sipas legjislacionit dhe rregullave të tregut.

2. Furnizuesi i ri paraqet në platformë konfirmimin e pranimit të klientit dhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e furnizimit, përfshirë kontratën e furnizimit.

3. Furnizuesi i ri nuk mund t'i kërkojë klientit dokumente ose të dhëna që janë tashmë të disponueshme në platformë ose që mund të verifikohen nga operatori i sistemit në sistemet përkatëse, përveç rasteve kur kërkesa është e nevojshme për identifikimin, për autorizimin ose për përmbushjen e një detyrimi ligjor.

4. Furnizuesi i ri është përgjegjës për saktësinë e të dhënave dhe të dokumenteve që paraqet në platformë.

Neni 9
Roli i operatorit të sistemit dhe administrimi i platformës

1. Operatori i sistemit me të cilin është i lidhur klienti administron platformën elektronike dhe garanton funksionimin e saj për regjistrimin, verifikimin, komunikimin dhe përfundimin e procedurës së ndryshimit të furnizuesit.

2. Operatori i sistemit verifikon të dhënat teknike dhe të dhënat e identifikimit të pikës së furnizimit, sipas të dhënave që administron.

3. Komunikimet ndërmjet operatorit të sistemit, furnizuesit aktual dhe furnizuesit të ri kryhen nëpërmjet platformës. Data dhe ora e çdo veprimi regjistrohen automatikisht në platformë dhe shërbejnë për llogaritjen e afateve.

4. Operatori i sistemit nuk vlerëson kushtet ekonomike të kontratës së furnizimit dhe nuk ndërhyn në marrëdhënien kontraktore ndërmjet klientit dhe furnizuesit, përveç rasteve kur një veprim i tillë kërkohet shprehimisht nga ligji ose nga kjo rregullore.

5. Çdo komunikim jashtë platformës, që lidhet me hapat proceduralë, pasqyrohet në platformë.

Neni 10
Afatet e procedurës

1. Ndryshimi i furnizuesit përfundon brenda afatit maksimal prej 3 (tre) javësh nga data e kërkesës së klientit, në përputhje me nenin 111, pika 7, të ligjit nr. 59/2026.

2. Operatori i sistemit, furnizuesi aktual dhe furnizuesi i ri i organizojnë veprimet e tyre në mënyrë që procedura të përfundojë brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Procesi teknik i ndryshimit të furnizuesit nuk zgjat më shumë se 24 (njëzet e katër) orë, pasi të jenë plotësuar kushtet për realizimin e ndryshimit dhe të jetë përcaktuar data e efektit të kontratës së re.

4. Platforma evidenton datën e fillimit të procedurës, afatet për çdo veprim, datën e miratimit ose të refuzimit, datën e ndryshimit teknik dhe datën e hyrjes në fuqi të kontratës së re.

5. Mosveprimi i një pale brenda afatit të përcaktuar në platformë nuk mund të përdoret për të zgjatur në mënyrë të pajustifikuar afatin maksimal të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 11
Përfundimi i procedurës dhe data e ndryshimit

1. Procedura konsiderohet e përfunduar kur operatori i sistemit regjistron në platformë realizimin e ndryshimit të furnizuesit dhe datën e hyrjes në fuqi të kontratës së re.

2. Nga data e ndryshimit, kontrata e furnizimit me furnizuesin e ri prodhon efekte juridike, ndërsa kontrata me furnizuesin aktual pushon së prodhuari efekte për furnizimin pas kësaj date, pa cenuar detyrimet e lindura deri në datën e ndryshimit.

3. Furnizuesi aktual dhe furnizuesi i ri kryejnë, secili për periudhën përkatëse të furnizimit, llogaritjet dhe faturimin përfundimtar, në përputhje me të dhënat e matjes dhe me rregullat në fuqi.

4. Klienti fundor ka të drejtë të marrë informacionin për konsumin dhe faturën e mbylljes së llogarisë jo më vonë se 20 (njëzet) ditë nga data e ndryshimit të furnizuesit.

Neni 12
Të dhënat e matjes dhe transferimi i informacionit

1. Operatori i sistemit i vë në dispozicion furnizuesit të ri të dhënat teknike dhe të dhënat e matjes që janë të nevojshme për fillimin e furnizimit, në përputhje me Kodin e Matjes, me kodet e rrjetit dhe me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Të dhënat e transmetuara identifikojnë qartë periudhën së cilës i referohen dhe, kur është e nevojshme, ndajnë konsumin deri në datën e ndryshimit nga konsumi pas kësaj date.

3. Operatorët e sistemit dhe furnizuesit ruajnë gjurmën elektronike të veprimeve të kryera në platformë dhe të dhënat përkatëse, në përputhje me detyrimet ligjore për ruajtjen e të dhënave.

Neni 13
Ndryshimi i furnizuesit për klientët me më shumë se një furnizues

1. Klienti fundor mund të ketë më shumë se një furnizues kur plotësohen kushtet teknike dhe të matjes të përcaktuara në legjislacion dhe në kodet e rrjetit.

2. Kur për furnizimin e klientit kërkohet përcaktimi i një pale përgjegjëse për balancimin, ky përcaktim realizohet në përputhje me rregullat e balancimit dhe me marrëveshjet përkatëse.

3. Procedura e ndryshimit të furnizuesit për secilën pikë furnizimi regjistrohet në platformën e operatorit përkatës dhe nuk mund të krijojë pengesa administrative të pajustifikuara për klientin.

Neni 14
Skemat kolektive të ndryshimit të furnizuesit

1. Klientët familjarë, si dhe ndërmarrjet mikro dhe të vogla, kanë të drejtë të marrin pjesë në skemat kolektive të ndryshimit të furnizuesit.

2. Operatorët e sistemit dhe furnizuesit zbatojnë procedurat e nevojshme për funksionimin e këtyre skemave nëpërmjet platformës elektronike, duke garantuar mbrojtjen e klientëve dhe shmangien e barrierave administrative të pajustifikuara.

3. Zbatimi i skemave kolektive nuk mund të krijojë kufizime, kosto ose kërkesa shtesë për klientët, përtej atyre të parashikuara nga ligji dhe nga aktet rregullatore në fuqi.

Neni 15
Furnizuesi i mundësisë së fundit

1. Furnizuesi i mundësisë së fundit furnizon klientët që mbeten pa furnizues në rastet e përcaktuara në nenin 109 të ligjit nr. 59/2026, përkatësisht kur furnizuesi i mëparshëm është në kushtet e paaftësisë paguese ose në proces falimentimi, kur licenca i është hequr ose i është pezulluar përkohësisht, ose kur klienti nuk ka arritur të gjejë një furnizues në treg.

2. Transferimi drejt furnizuesit të mundësisë së fundit ose prej tij kryhet nëpërmjet platformës së operatorit përkatës të sistemit, në përputhje me rregullat e miratuara nga ERE-ja dhe me kushtet e përcaktuara në nenin 109 të ligjit nr. 59/2026.

3. Për procedurat, afatet, të dhënat dhe kushtet kontraktore të furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit zbatohen edhe aktet e posaçme të ERE-s për këtë veprimtari.

PJESA III
MBROJTJA E TË DHËNAVE, ANKESAT DHE FUNKSIONIMI I PLATFORMËS

Neni 16
Mbrojtja e të dhënave dhe gjurmueshmëria

1. Të gjitha të dhënat e përpunuara gjatë procedurës përdoren vetëm për qëllimet e ndryshimit të furnizuesit dhe për përmbushjen e detyrimeve ligjore e rregullatore.

2. Platforma siguron autentifikimin e përdoruesve, kontrollin e aksesit, regjistrimin e veprimeve dhe gjurmueshmërinë e komunikimeve dhe të vendimeve të marra gjatë procedurës.

3. ERE-ja ka akses, si përdorues i autorizuar, në të dhënat dhe në informacionin e disponueshëm në platformë, përfshirë të dhënat për aplikimet, statusin dhe ecurinë e procedurave, komunikimet, vendimet, afatet, ndryshimet e realizuara dhe të dhënat e tjera të regjistruara në platformë, në masën e nevojshme për ushtrimin e funksioneve dhe të kompetencave të saj ligjore dhe rregullatore.

4. Aksesi i ERE-s realizohet nëpërmjet kredencialeve të posaçme të përdoruesit dhe mundëson konsultimin, monitorimin dhe gjurmimin e procedurave, pa cenuar integritetin e të dhënave dhe pa i dhënë ERE-s të drejtën e ndryshimit të të dhënave të regjistruara nga palët.

5. Përpunimi dhe ruajtja e të dhënave bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe me kërkesat e sigurisë së informacionit.

Neni 17
Ankesat dhe procedimi administrativ

1. Çdo ankesë që lidhet me procedurën e ndryshimit të furnizuesit mund t'i paraqitet ERE-s, në përputhje me legjislacionin dhe me rregullat procedurale në fuqi.

2. Ankesa nuk pezullon afatin për ndryshimin e furnizuesit dhe/ose hyrjen në fuqi të kontratës së re të furnizimit, përveç rasteve kur ligji ose një vendim i ERE-s parashikon ndryshe.

3. Paraqitja e ankesës nuk cenon të drejtën e klientit për të marrë informacionin dhe të dhënat që lidhen me statusin e procedurës në platformë.

4. ERE-ja ka të drejtë të nisë kryesisht procedim administrativ ndaj operatorit të sistemit, furnizuesit aktual ose furnizuesit të ri, kur konstaton ose disponon të dhëna për shkelje të dispozitave të kësaj rregulloreje, të afateve, detyrimeve dhe procedurave të përcaktuara për ndryshimin e furnizuesit, si dhe të detyrimeve të tjera ligjore dhe rregullatore që lidhen me këtë proces. Procedimi administrativ zhvillohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me kompetencat e ERE-s, pa qenë e nevojshme paraqitja paraprake e një ankese nga klienti fundor.

Neni 18
Detyrimet për funksionimin e platformës

1. OST-ja dhe OSSH-ja sigurojnë që platformat e tyre për ndryshimin e furnizuesit të mundësojnë, së paku:

a) regjistrimin e aplikimit;

b) identifikimin e palëve;

c) komunikimin elektronik ndërmjet palëve;

ç) verifikimin e statusit të detyrimeve;

d) regjistrimin e kontratës së re;

dh) përcaktimin e datës së ndryshimit;

e) regjistrimin e veprimeve teknike;

ë) njoftimet automatike;

f) gjenerimin e historikut të procedurës.

2. Platformat sigurojnë trajtim të barabartë të furnizuesve dhe nuk krijojnë pengesa teknike ose administrative që cenojnë të drejtën e klientit për të ndryshuar furnizuesin.

3. Çdo ndërprerje e platformës që ndikon në llogaritjen ose në përmbushjen e afateve dokumentohet dhe trajtohet sipas procedurës së administrimit të incidenteve të platformës. Operatorët e sistemit njoftojnë ERE-n për ndërprerjet që mund të ndikojnë në përmbushjen e afatit maksimal ligjor.

PJESA IV
DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 19
Rishikimi dhe ndryshimi i rregullores

Kjo rregullore rishikohet dhe ndryshohet me vendim të Bordit të ERE-s.

Neni 20
Dispozita kalimtare

1. Procedurat e ndryshimit të furnizuesit të filluara përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje përfundojnë sipas rregullave në fuqi në datën e fillimit të tyre, përveç rasteve kur zbatimi i menjëhershëm i një dispozite të ligjit nr. 59/2026 është i detyrueshëm.

2. Brenda [___] muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, OST-ja dhe OSSH-ja i përshtatin platformat elektronike me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe i vënë në dispozicion ERE-s dokumentacionin përkatës për funksionalitetet e tyre.

Neni 21
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.